

Vendim nr. 253 datë 09.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (N) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: NORA MALAJ

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1493 akti, datë 25.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit”.
Caktimi në pjesën urdhëruese të vendimit të organit të ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 44, 131, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141 dhe 142, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71, 71/a, 71/ç, pikat 3 dhe 4, si dhe 81, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, me urdhrin e datës 24.12.2003 të Këshillit të Ministrave, është emëruar në detyrën e kryetares së komitetit “Për mundësi të barabarta”. Këtë funksion ajo e ka ushtruar deri në datën 01.06.2005, kur me urdhrin e datës 27.05.2005 të Këshillit të Ministrave është vendosur largimi i saj nga detyra. Kërkuesja e ka kundërshtuar aktin e largimit gjyqësisht, duke kërkuar kthimin në detyrë dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5200, datë 21.09.2005, ka vendosur pranimin e padisë, anulimin e aktit administrativ të datës 27.05.2005, rikthimin e kërkueses në vendin e mëparshëm të punës, si dhe detyrimin e Këshillit të Ministrave të paguajë në favor të saj pagën për kohën e qëndrimit pa punë që fillon nga data 27.05.2005 deri në ekzekutimin e vendimit në shumën 68.560 lekë. Palët nuk e kanë ankimuar vendimin, ndaj ai ka marrë formë të prerë. Në datën 25.11.2005 gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

3. Kërkuesja ka parashtruar se prej vitit 2007 ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke iu drejtuar fillimisht përmbaruesit gjyqësor shtetëror dhe më pas atij privat. Ky i fundit, në datën 22.11.2011, ka kryer lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe më pas në datën 05.12.2011 ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative në llogarinë e Këshillit të Ministrave. Përgjatë periudhës 12.12.2011-03.02.2025 përmbaruesi gjyqësor ka njoftuar në mënyrë të vazhdueshme Këshillin e Ministrave, ministrinë që ka mbuluar çështjet financiare dhe ato sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Degën e Thesarit Tiranë për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit, por pa sukses.

4. Në datën 05.02.2019 Dega e Thesarit Tiranë ka njoftuar përmbaruesin se nuk mund ta ekzekutonte vendimin gjyqësor, pasi Këshilli i Ministrave nuk dispononte fonde buxhetore ose artikuj të posaçëm në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe as kodin shtatëshifror për kryerjen e procedurave financiare në sistemin e thesarit. Ndërsa në datën 24.02.2025 Departamenti i Miradministrimit në Kryeministri ka informuar se Këshilli i Ministrave është organ kolegjal dhe nuk ka një zë të veçantë në buxhetin e shtetit për shlyerjen e detyrimeve (ish-punonjësve të

institucioneve të tjera), të pajisur me titull ekzekutiv, duke e orientuar t'i drejtohet njësisë shpenzuese përgjegjëse.

5. Në datën 19.05.2025 kërkesja ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 26.05.2025.

6. Kolegji i Gjykatës, pasi ka marrë në shqyrtim paraprak kërkesën, me vendimin e datës 08.07.2025, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim të metash brenda 10 ditëve nga marrja dijani e tij, me qëllim paraqitjen e provave ose të argumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Në datën 30.09.2025 kërkesja ka paraqitur me shkrim aktin me lëndë kthim përgjigjeje, në përmbajtje të të cilit ka parashtruar argumentet e saj.

II

Pretendimet e kërkeses

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në aspektin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit të gjykatës brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar për 20 vjet. Pala debitore nuk ka kryer asnjë veprim, qoftë për të dëshmuar vullnetin e saj për të filluar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke refuzuar zbatimin e vendimit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkeses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se në vendimin e tij të datës 08.07.2025, për plotësimin e të metave të ankimit, ka vënë në dukje paqartësi për sa i takon faktit nëse kërkuesja ka shfrytëzuar paraprakisht mjetin juridik mbrojtës në gjykatat e zakonshme të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ose nëse mjeti në dispozicion ishte joefektiv. Në përgjigjen e paraqitur në datën 30.09.2025, kërkuesja ka parashtruar se ajo i është drejtuar Gjykatës, pasi, sipas saj, vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, ndaj përpara ligjit janë shteruar të gjitha shkallët e gjykimit dhe se neni 399/1 i KPC-së lidhet vetëm me konstatimin e cenimit të së drejtës dhe jo me caktimin në pjesën urdhëruese të vendimit të organit të ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse.

11. Kolegji konstaton se këto argumente, në thelb, i referohen gjykimit të themelit të çështjes, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka disponuar me vendimin nr. 5200, datë 21.09.2005, që ka marrë formë të prerë, pasi asnjë nga palët nuk e ka ankimuar atë. Ndërkohë nga përgjigjja e kthyer nuk rezulton që kërkuesja t'u jetë drejtuar paraprakisht gjykatave të zakonshme me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, i cili është edhe objekti i ankimit kushtetues individual i paraqitur prej saj. Kjo do të thotë se ajo i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

12. Lidhur me këtë situatë, Kolegji sjell në vëmendje se ligji procedural civil ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja nga gjykatat e zakonshme në rastet e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata ka vlerësuar se qëllimi parësor i këtyre mjeteve juridike është njohja e shkeljes

së kërkesës për “afat të arsyeshëm” dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshpejtimit të tij e, në eventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të dëmit. Sipas Gjykatës, është e nevojshme që edhe vetë individi të tregojë kujdesin e duhur, në kohën e duhur. Thënë kjo, individi duhet të përdorë në kohën e duhur mjetin juridik parandalues/përshpejtues (kupto kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave). Një qasje e tillë përputhet me qëllimin e mjeteve juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, si dhe me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e zakonshme nuk kanë qenë në gjendje të riparojnë shkeljet e së drejtës për proces të rregullt (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kontekst të sa më sipër, Kolegji evidenton se kërkesja, ndonëse i ka pasur të gjitha mundësitë, nuk u është drejtuar gjykatave të zakonshme me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor, sipas parashikimeve të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, procedurë në të cilën duhej të ishin shqyrtuar edhe pretendimet për sjelljen e autoriteteve dhe kompleksitetin e çështjes (organi i caktuar për përmbushjen e detyrimit dhe procedura për ekzekutimin). Me fjalë të tjera, ajo nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike mbrojtëse që ka pasur në dispozicion për t’iu drejtuar fillimisht gjykatave të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual.

14. Në këtë kuptim, kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Për më tepër, ajo ka kthyer përgjigje për plotësimin e ankimit kushtetues individual përtej afatit 10-ditor nga marrja dijeni.

15. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.